



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Numri i Ceshtjes : 71041-00858-11-2015

Data e Regjistrimit : 12/05/2015

Numri i Vendimit: 11-2015-2907

Data e Vendimit : 17/06/2015

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Anita Mici

SEKRETARE:

Sot më datë 17/06/2015mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Kërkues ID , i biri i Is dhe i S, i datëlindjes 07/03/1111

Objekti:Heqjen e sekuestros te references Nr. 2486 ZK 8514 te pasurise Nr.4/142+1-17 nga ZVRPP

Durrës dhe kthimin e proves materiale vertetimit dokumentit hipotimor Nr 1011 date 28.09.1998 (origjinal)

Baza Ligjore:Nenet 187,188,189,190 e vijues K.Pr.Penale.

Ne përfundim te shqyrtimit gjyqësor Gjykata:

- Pasi dëgjoi kërkuesin Islam Dedej, i cili kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit te saj.
- Pasi dëgjoi prokuroren Elena Pelushi ne konkluzionet përfundimtare, e cila kërkoi pranimin e kërkesës.
- dhe pasi shqyrtoi dhe vlerësoi aktet me cilësinë e provës.

Vëren

Përmbledhje:

Ne përfundim te shqyrtimit gjyqësor Gjykata:

- Pasi dëgjoi kërkuesin ID, i cili kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit te saj.
- Pasi dëgjoi prokuroren Elena Pelushi ne konkluzionet përfundimtare, e cila kërkoi pranimin e kërkesës.
- dhe pasi shqyrtoi dhe vlerësoi aktet me cilësinë e provës.

Konkluzioni:

Kërkuesi ***** i është drejtuar Gjykatës se Rrethi Gjyqësor Durrës me kërkesë me objektin e mësipërm, duke kërkuar përfundimisht “Heqjen e sekuestros te referencës Nr.2486 ZK 8514 te pasurisë Nr.4/142+1-17 nga ZVRPP Durrës dhe kthimin e provës materiale vërtetimit dokumentit hipotekor Nr.1011, date 28.09.1998 (origjinal).

Për shqyrtimin e kësaj kërkesë, Gjykata tërhoqi me cilësinë e provës te gjithë materialin hetimor ne baze te te cilit është marre nga prokurori vendimi objekt gjykimi dhe ne përfundim te shqyrtimit gjyqësor rezultoi e provuar se:

Kërkuesi ***** është paraqitur në ZVRPP Durrës për të aplikuar për t'u pajisur me CertifikatëPpronësie për pasurine e tij te paluajtshme apartament banimi që i përket pasurisë Nr.4/142+1-17 e ndodhur në lagjen Nr.03, Rruga “Egnatia”, Pallati Nr.1029, Durrës.

Nga ana e ZVRPP Durrës me shkresën me Nr.1610 Prot., datë 27.02.2015 i është kthyer përgjigje se ky shërbim nuk i plotësohet pasi, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për efekte të hetimit të një çështje penale është sekuestruar referenca me Nr.2486 zonë kadastrave 8514 të pasurisë me Nr.4/142+1-17 që i përket kërkuesit *****.

Në lidhje me sekuestrimin e bërë nga ana e Prokurorisë së Rrethit Durrës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin e saj Nr.344, datë 24.06.2009 nuk është shprehur për disponimin e provave materiale, ku përfshihet edhe dokumenti origjinal i pronësisë (vërtetimi hipotekor Nr.1011, datë 28.09.1998) që i përket pasurisë Nr.4/142 zonë kadastrave 8514, të kërkuesit *****.

Referuar nenit 208 paragrafi i pare te K.Pr.Penale: “Gjykata ose prokurori disponojne me vendim te arsyetuar sekuestrimin e provave dhe **te sendeve qe lidhen me veprën penale**, kur ato janë te domosdoshme për vërtetimin e fakteve”.

Referuar nenit 212 te K.Pr.Penale, kërkuesi ***** ka legjitimitet ne ngritjen e kësaj kërkesë pasi është personi qe ka ne disponim dokumentin mbi te cilat është vendosur sekuestroja. Ne kuptim te nenit 218, pika 1) te K.Pr.Penale, Gjykata u bind për përkatësinë e dokumentit të këtij gjykimi dhe ligjshmërinë e posedimit te tij, dhe ne këto rrethana vlerëson se duhet t'a pranoje kërkesën e palës kërkuese *****.

Arsyeja:

Gjykata bazuar ne nenet 190, pika 1), germa ç) dhe 218, pika 1) te K.Pr.Penale

Vendimi:

- Pranimin e kërkesës së kërkuesit *****.
- Heqjen e sekuestros mbi referencen me Nr.2486 Z.K Nr.8514 te pasurisë Nr.4/142+1-17 nga ZVRPP Durrës dhe kthimin e provës materiale Vërtetim nga Dokumentit Hipotekor Nr.1011, date 28.09.1998 (origjinal) kërkuesit *****, duke u pajisur ky shtetas me Certificate Pronesie per pasurine e mesiperme.
- Kundër vendimit mund të bëhet ankim brenda 10 (dhjetë) ditëve nga e nesërmja e shpalljes në Gjykatën e Apelit Durrës.
- **U shpall në Durrës me 17.06.2015**